



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Majlinda Bedrolli	04.08.2026	10.08.2026	2026/0557

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 01.08.2026, GOE “DARDANIA SH.P.K& CONEX L.L.C.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0557, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “ALBANI AA.LL.C.”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Rrenimi i objekteve te shpronesuara nga Komuna e Pejës” me nr. të prokurimit: "635-26-580-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 120,000.00 €. Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2026/0320 i dt:24.06.2026. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat e shkelura nga AK-Komuna Pejë:

Neni 1 i LPP-se

Neni 6 i LPP-se

Neni 7 i LPP-se

Neni 24 i LPP-së

Neni 25 i LPP-së

Neni 56.3 i LPP-se

Neni 59 i LPP-se

Neni 60 i LPP-se

Neni 61 i LPP-se

Neni 11 i Udhezuesit të Prokurimit Publik

Neni 108 A i LPP-se

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK-Komuna Peje lidhur me aktivitetin e prokurimit **Rrënimi i objekteve të shpronësuar nga Komuna e Pejës** me nr.prok. **635-26-580-2-2-1** me arsyetimin se oferta jonë është me çmim jo normalisht të ulët, duke mos i marr fare parasysh sqarimet tona të datës 06.07.2026 sipas kërkesës së Ak-së, dhe duke mos u bazuar në fakte dhe prova, të cilat AK nuk i merr fare parasysh pasi qëllim i AK-së shihet se është eliminimi i ofertës sonë për këtë aktivitet dhe shperblimi i OE së preferuar të tyre, ashtu siç e ka shpërblyer me kontratë dy herë radhazi.

-Arsyeja e eliminimit tonë nga AK është si vijon:

Njoftim për Refuzim të Ofertës –OE DARDANIAA SH.P.K.; CONEX L.L.C.

Arsyetimi për mospranimin e sqarimeve të Operatorit Ekonomik lidhur me tenderin jo normalisht të ulët Komisioni i Vlerësimit, pas shqyrtimit të përgjigjes së dorëzuar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik DARDANIAA SH.P.K.; CONEX L.L.C. në përgjigje të kërkesës së Autoritetit Kontraktues (B41 – Kërkesë për informata mbi tenderin jo-normalisht të ulët), ka konstatuar se Operatori Ekonomik ka paraqitur shpjegime lidhur me mënyrën e realizimit të punimeve dhe formimin e çmimeve të ofertuara. Megjithatë, shpjegimet e dhëna kanë mbetur në nivel deklarativ dhe nuk janë mbështetur me dokumente dhe dëshmi objektive, të cilat ishin kërkuar shprehimisht nga Autoriteti Kontraktues për të provuar realizueshmërinë ekonomike dhe teknike të ofertës. Në kërkesën B41, Autoriteti Kontraktues kishte kërkuar që për secilin pozicion të Paramasës dhe Paralogarisë të paraqiteshin analiza të detajuara të kostove dhe dokumentacion mbështetës për elementet përbërëse të çmimit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, kostot e fuqisë punëtore, makinerive dhe pajisjeve, transportit, deponimit të materialit, derivateve, mirëmbajtjes, amortizimit, shpenzimeve operative dhe fitimit, si dhe çdo dokument tjetër që do të mundësonte verifikimin objektiv të realizueshmërisë së ofertës. Nga shqyrtimi i përgjigjes së Operatorit Ekonomik është konstatuar se, ndonëse janë dhënë shpjegime për mënyrën e organizimit të punimeve dhe janë përmendur burimet njerëzore dhe pajisjet në dispozicion, nuk janë dorëzuar dokumente dhe prova objektive që mbështesin këto pretendime dhe që dëshmojnë se çmimet e ofertuara mbulojnë të gjitha kostot e nevojshme për realizimin e kontratës. Komisioni vëren se dokumentet e dorëzuara në fazën e ofertimit lidhur me personelin dhe pajisjet shërbejnë për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve të kualifikimit dhe kapacitetin teknik të Operatorit Ekonomik, por ato nuk përbëjnë prova për realizueshmërinë ekonomike të çmimeve të ofertuara dhe nuk zëvendësojnë dokumentacionin e kërkuar në procedurën e shqyrtimit të tenderit jo-normalisht të ulët. Po ashtu, Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion mbështetës që do të mundësonte verifikimin e analizës së kostove për çmimet e ofertuara prej 2.80 €/m³, 1.50 €/m³ dhe 1.70 €/m³, si dhe nuk ka paraqitur prova objektive që vërtetojnë se me vlerën e përgjithshme të ofertës prej 58,850.00 € mund të realizohen të gjitha obligimet kontraktuale në përputhje me Specifikimet Teknike, Paramasën, Kushtet e Kontratës dhe standardet e kërkuara të cilësisë. Autoriteti Kontraktues nuk mund ta bazojë vlerësimin e realizueshmërisë së ofertës vetëm në deklaratimet e Operatorit Ekonomik. Barra për të provuar realizueshmërinë e ofertës i takon Operatorit Ekonomik përmes paraqitjes së provave dhe dokumentacionit mbështetës të mjaftueshëm dhe të verifikueshëm. Në mungesë të këtyre provave, Autoriteti Kontraktues nuk ka qenë në gjendje të verifikojë objektivisht realizueshmërinë ekonomike dhe teknike të ofertës. Për rrjedhojë, Komisioni i Vlerësimit vlerëson se sqarimet e dorëzuara nuk përmbushin kërkesat e përcaktuara në letrën B41 dhe nuk ofrojnë bazë të mjaftueshme për të konstatuar se oferta është ekonomikisht dhe teknikisht e

dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe rregulloreve përkatëse që rregullojnë trajtimin e tenderëve jo-normalisht të ulët.

Përgjigjet sqarimet tona të kërkesës për sqarime të datës 03.07.2026 e që ne ua kemi dërguar me datë 06.07.2026:

Duke u bazuar në kërkesën e datës **03.07.2026** nga AK – Komuna e Pejës lidhur me informatat mbi çmimin jo-normalisht të ulët, ne si OE në bashkëkonzorcium konsiderojmë se oferta jonë ka qenë e përgjegjshme dhe totalisht e analizuar në mënyrë të detajuar për secilin pozicion. Ne mbetemi plotësisht të gatshëm për realizimin e kontratës sipas çmimit të ofertuar dhe, në rast se shpallemi fitues nga AK, do ta nënshkruajmë kontratën, ndërsa AK përfiton edhe sigurimin e ekzekutimit në vlerë prej **10%** të ofertës sonë, respektivisht nga vlera e ofertës prej **58,850.00 €**, sigurimi i performancës është **5,885.00 €**, si çështje sigurie për realizimin e kontratës.

Mbi të gjitha, lidhur me këtë sqarim dhe me detajet e kërkuara nga AK, konsiderojmë se AK fillimisht është dashur të veprojë në përputhje me **nenin 38 të RrPP-së**, konkretisht me **paragrafin 38.6**, duke i dhënë OE-së mundësinë për sqarimin e tenderit të tij, si për çmimin ashtu edhe për ofertën, pasi në disa nga pikat e kërkuara nga AK janë kërkuar edhe sqarime të tjera. Një veprim i tillë duhet të bëhet duke caktuar një afat kohor jo më të shkurtër se **5 ditë pune** për OE.

Në rastin konkret, AK e ka dorëzuar kërkesën për sqarim më **03.07.2026- ora:14:00**, ndërsa afati përfundimtar për dorëzimin e përgjigjes është caktuar më **06.07.2026 ora 14:00-(i ka numeruar edhe ditet e vikendit, ku dihet që dita e shtune dhe e diele janë ditë pushimi sipas ligjit)**. Nga kjo pikëpamje dhe duke marrë parasysh analizën që është kërkuar për sqarim ndaj OE-së, shihet se është kërkuar një analizë me përmbajtje të gjerë dhe volum të konsiderueshëm të dokumentacionit ku mendojmë se është tejkaluar neni 61 i LPP-së ku shumë qartë paragrafi 2 i këtij neni sqaron se cilat arsye duhet të sjellë OE për të sqaruar një tender që ka cmime jo-normalisht të ulët, andaj, për më tepër, duke pasur parasysh se të gjitha veprimet dhe sqarimet duhet të realizohen brenda afatit jo më të shkurtër se **5 ditë pune**, kjo kërkesë urgjente në një afat kaq të shkurtër na shtyn të dyshojmë se sqarimi kërkohet vetëm që AK të veprojë me shpejtësi për një refuzim të mundshëm të tenderit sipas **nenit 61, paragrafët 4 dhe 5**, të ndërlidhur me **nenin 41 të RrPP-së**, konkretisht **paragrafin 41.10, pikat (a) dhe (b)**.

Mbi të gjitha, një veprim i tillë na duket tendencioz. Megjithatë, duke u bazuar në të gjitha veprimet dhe vendimet e fundit të OSHP-së, në letrat standarde të dorëzuara, si dhe në ligjet dhe legjislacionin në fuqi, ne si OE, me të drejtën tonë për trajtim të barabartë, japim sqarime të bazuara në informata të sakta dhe deklarojmë se ndihemi plotësisht të bindur,

si teknikisht ashtu edhe ekonomikisht, për realizimin e këtij projekti, pavarësisht veprimeve tendencioze dhe diskriminuese, të cilat i konsiderojmë si degradim institucional ndaj nesh si grup i OE-ve.

POZICIONI 1:

- **Analiza e detajuar e çmimit për 1 m³**

Ne si GOE, duke u bazuar në **Aneksin 1** të Dosjes së Tenderit dhe në paramasën/ofertën, ku është kërkuar që çmimi të ofertohej për m³, më saktësisht për **pozicionin 1**, ku kërkohet sasia prej **19,000 m³** deklarohet qartë sasinë dhe vëllimin, kemi ofertuar çmimin prej **2.80 €/m³**, të analizuar në mënyrë të detajuar sipas kërkesave të AK-së në Dosjen e Tenderit dhe në paramasë.

Mbi të gjitha, në kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga ne si GOE, konkretisht anëtar i konzorciumit **CONEX**, të datës **03.03.2026**, para hapjes së ofertave, është potencuar se: "Në procedurën aktuale, Autoriteti Kontraktues ka paraparë sasi prej **22,500 m³** për periudhë 24-mujore. Megjithatë, në Dosjen e Tenderit nuk janë dhënë lokacionet konkrete të objekteve për rrënim, nuk është bashkëngjitur asnjë projekt apo elaborat teknik për të vërtetuar sasinë, nuk janë paraqitur paramasa të detajuara sipas objekteve individuale dhe nuk është dhënë asnjë arsyetim mbi metodologjinë e kalkulimit të kësaj sasive. Gjithashtu, nuk është organizuar asnjë **site- visit**, që do t'u mundësonte operatorëve ekonomik verifikimin real në terren të vëllimit dhe kompleksitetit të punimeve.

Nëse Autoriteti Kontraktues thekson se rrënimet do të kryhen sipas kërkesave të Komunës, atëherë lind pyetja logjike dhe juridike: si është përcaktuar paraprakisht sasia e saktë prej **22,500 m³** dhe mbi çfarë baze teknike është përllogaritur kjo sasi? Pa projekte, pa lokacione dhe pa elaborime konkrete teknike, operatorët ekonomikë nuk kanë mundësi të bëjnë kalkulim real të kostos, të rrezikut financiar, të angazhimit të makinerisë dhe të fuqisë punëtore. Një situatë e tillë krijon pasiguri juridike dhe ekonomike dhe ndikon drejtpërdrejt në formimin e çmimit të ofertës."

Me datën **20.02.2026**, AK – Komuna e Pejës ka theksuar se kërkesa për rishqyrtim aprovet pjesërisht si e bazuar dhe se ndryshohet **Aneksi 1**, gjë që vërtetohet edhe me **Formularin B54**, të datës **04.03.2026**

Mbi të gjitha, pas aprovimit, vetë AK – Komuna e Pejës, në vendimin për rishqyrtim, ka theksuar se, (citim): bazuar në analizat statistikore të realizimeve paraprake, gjatë një viti realizohen rreth **8,000 deri në 10,000 m³** punime. Gjithashtu, lidhur me lokacionet, sipas pikës 5 të vendimit, është theksuar se ndërhyrjet realizohen sipas nevojave reale dhe vendimeve administrative për shpronësim, prandaj lokacionet nuk mund të jenë të përcaktuara plotësisht paraprakisht, por bazohen në vendimet që lëshohen gjatë periudhës kontraktore.

Andaj, ne si GOE, duke u bazuar në këto vendime dhe ndryshime të bëra nga vetë Autoriteti Kontraktues, kemi konstatuar dhe vlerësuar se sasinë e parapara janë rreth **8,000 deri në**

10,000 m³ në vit. Për më tepër, vetë AK, në përfundim të vendimit, ka theksuar se operatorët ekonomik kanë informacione të mjaftueshme për përgatitjen e ofertave të tyre. Duke u mbështetur në këto të dhëna zyrtare, ne kemi ofertuar çmimin prej **2.80 €/m³**.

- **Kostoja e fuqisë punëtore dhe numri e puntorëve të angazhuar**

Duke qenë se në DT janë kërkuar të angazhohen 5 punëtorë, ne si konzorcium kemi paraqitur listat e punëtorëve, si të liderit ashtu edhe të anëtarit të konzorciumit. Nga kjo pikëpamje, ose lideri ose anëtari do të angazhojë staf prej 5 punëtorëve, të cilët do të kyçen për kryerjen e këtyre shërbimeve sipas kërkesave të AK-së.

Duke pasur parasysh se punëtorët tanë janë me kosto fikse, me paga fikse mujore, si në zbatimin e kësaj kontrate ashtu edhe të kontratave të tjera, të cilët janë të angazhuar paraprakisht, përlogaritja është si vijon:

5 punëtorë × 500.00 € = 2,500.00 €.

: 10,000 m³, të parapara për 1 vit sipas vetë vendimit të AK-së, rezulton rreth 0.25 €/m³.

- **Numri i ditëve të punës**

Nga kërkesa për rishqyrtim e anëtarit të konzorciumit **CONEX**, e datës **20.02.2026**, është theksuar se operatorët ekonomikë nuk kanë mundësi, bazuar në të dhënat e ofruara nga AK, të kalkulojnë sasinë, pasi nuk ka elaborim teknik të detajuar.

Meqenëse kjo kërkesë për rishqyrtim është pranuar pjesërisht si e bazuar nga AK, vetë AK ka theksuar se ndërhyrjet realizohen sipas nevojave reale dhe vendimeve administrative për shpronësim. Për këtë arsye, lokacionet nuk mund të jenë të përcaktuara plotësisht paraprakisht, por bazohen në vendimet që lëshohen gjatë periudhës kontraktore.

Për këtë arsye, edhe ne si OE nuk mund ta dimë numrin e ditëve të punës dhe produktivitetin, pasi kjo varet nga vendimet administrative që do të nxjerrë AK. Mbi të gjitha, AK mund të na dërgojë vendimet administrative për shpronësimet apo planifikimin e saktë dhe më pas mund t'i ndajmë apo veçojmë ditët e punës sipas nevojës.

Për më tepër, në ofertën tonë kemi dorëzuar planin dinamik të detajuar mujor, nga i cili shihet se jemi aktivë gjatë gjithë periudhës **24-mujore** dhe i përgjigjemi kërkesave të AK-së

- **Lloji makinerisë dhe dëshmia e pronësisë**

Në ofertën tonë kemi paraqitur eskavatorët dhe pajisjet e tjera përcjellëse që nevojiten për realizimin e këtij projekti që do të ekzekutohet sipas paramasës së DT-së dhe për këtë i kemi dëshmit e paisjeve edhe në dosje që rezulton se nga dëshmit e ofruara ne jemi të gatshëm të ekzekutojm kontratën pa asnjë dilem të vetme dhe në kohën optimale të kërkuar nga AK për shërbimin sipas kontratës.

Të njëjtat dëshmi i kemi dorëzuar edhe në ofertën tonë, duke i specifikuar më saktë në listën e pajisjeve. Gjithashtu, kemi paraqitur edhe kontratën e qirasë së makinerive me disa

OE të tjerë siq janë në ofertën tone e dorëzuar në platformën e-prokurimi.

Kostoja e mirëmbajtjes

Kryesisht, gjatë muajit janar kryejmë të gjitha serviset e nevojshme për të gjitha makineritë, të financuara nga fitimet e projekteve të tjera apo nga profiti i kompanisë. Në raste emergjente të ndonjë defekti në vendpunishte, kemi staf profesional që kryen intervenimet. Për **10,000 m³** në vit mund të arrijmë në përfundim se kostot e mirëmbajtjes për makineritë e kërkuara sipas DT-së janë:

- 1 kamion – **200 €** në vit;
- 1 bager – **400 €** në vit;
- 1 kamionetë – **150 €** në vit;
- 1 kompresor – **20 €** në vit;
- 1 Hilti – **10 €** në vit.

Gjithsej, kostoja e mirëmbajtjes për makineritë e caktuara që do të angazhohen për këtë projekt është **780 € × 2 vite = 1,560 €**.

: **19,000 m³** të parapara rezulton rreth **0.08 €/m³**.

Kostoja e amortizimit

Kryesisht, makineritë janë amortizuar gjatë viteve që nga blerja, mirëpo mund të specifikojmë një amortizim vjetor që rezulton rreth **0.03 €/m³**.

Kostoja deri në Sferkë

Duke marrë parasysh vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim të AK-së, të datës **20.02.2026**, para fazës tenderuese, ku është potencuar se lokacionet nuk mund të jenë të përcaktuara plotësisht paraprakisht, por bazohen në vendime administrative, edhe ne, duke u bazuar në këtë vendim të AK-së, nuk mund të japim një lokacion të saktë.

Megjithatë, për korrektësi, marrim si pikë reference qendrën e Pejës. Nga sheshi i qytetit deri te deponia në Sferkë distanca është rreth **40 km**, apo **80 km** vajtje-ardhje.

Me një shpenzim për kamion prej rreth **20 litra × 1.25 €**, sipas çmimit të derivateve në muajin mars 2026, rezultojnë **25 €** për një ngarkesë prej **20–22 m³** në kamion.

Një kamion, mesatarisht, arrin të realizojë **15 transportime**, respektivisht **330 m³**, me një shpenzim total prej rreth **230 €**.

Kapaciteti i kamionëve sipas DT-së është kërkuar të jetë vetëm **1 kamion**. Ne kemi ofruar disa kamionë, mirëpo sipas kërkesës së AK-së, gjatë intervenimit do të angazhohet vetëm një kamion. Kostoja mesatare për kilometër është rreth **0.25–0.30 €**.

Kostoja e ngarkimit dhe shkarkimit

Për ngarkimin, sipas Dosjes së Tenderit është kërkuar **1 eskavator me goma**, ndërsa shpenzimet për **1 orë** janë rreth:

20 litra × 1.25 € = 25 €.

Me **4 orë efektive pune**, rezultojnë **100 €**, të cilat ndahen për **330m³** në ditë, duke rezultuar

në rreth 0.30 €/m³.

Kostoja e trajtimit dhe deponimit të materialit

Nuk ka kosto për deponimin e materialit, pasi i njëjti, pas rrënit, ngarkohet drejtpërdrejt në kamion dhe dërgohet në deponi.

Shpenzimet e sigurimit të vendpunishtes

Meqenëse posedojmë rrethojat e kompanisë dhe punëtorët tanë janë me paga fikse, punëtorët angazhohen edhe për sigurimin e vendpunishtes, prandaj kjo kosto është e përfshirë në koston e fuqisë punëtore.

Masat e sigurisë dhe mbrojtjes në punë

Masat e sigurisë dhe mbrojtjes në punë janë të paraqitura me kosto fikse sipas marrëveshjeve dhe kontratave në fuqi me punëtorët.

Kosto administrative

Shpenzimet administrative për shtypjen e situacioneve, faturave, ditarit ndërtimor dhe librit ndërtimor janë vlerësuar në 500 € për të gjithë projektin.

Përqindja e fitimit

Përqindja e fitimit është 10%, pasi nga ky projekt, përveç fitimit, pretendojmë të punojmë edhe për imazh të kompanisë, dhe të kemi kontrata me Komunën e Pejës dhe të fitojmë referenca që do të na ndihmojnë në projektet e tjera.

Çdo dokument

Nga të gjitha pikat e lartcekura kemi konstatuar dhe bashkëngjitur dokumentet përkatëse, të cilat janë të nevojshme dhe të dedikuara për këtë projekt që gjinden në ofertën tonë të dorëzuar në platformën e-prokurimi.

POZICIONI 2:

• Analiza e detajuar e çmimit për 1 m³

Ne si GOE, duke u bazuar në **Aneksin 1** të Dosjes së Tenderit dhe në paramasën/ofertën, ku është kërkuar që çmimi të ofrohet për m³, më saktësisht për **pozicionin 2**, ku kërkohet sasia prej **1,500 m³** deklaror qartë sasinë dhe vëllimin, kemi ofertuar çmimin prej **1.50 €/m³**, të analizuar në mënyrë të detajuar sipas kërkesave të AK-së në Dosjen e Tenderit dhe në paramasë.

Mbi të gjitha, në kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga ne si GOE, konkretisht anëtar i konzorciumit **CONEX**, të datës **03.03.2026**, para hapjes së ofertave, është potencuar se: "Në procedurën aktuale, Autoriteti Kontraktues ka paraparë sasi prej **1,500 m³** për periudhë 24-mujore. Megjithatë, në Dosjen e Tenderit nuk janë dhënë lokacionet konkrete të objekteve për rrënim, nuk është bashkëngjitur asnjë projekt apo elaborat teknik për të vërtetuar sasinë, nuk janë paraqitur paramasa të detajuara sipas objekteve individuale dhe nuk është dhënë asnjë arsyetim mbi metodologjinë e kalkulimit të kësaj sasive. Gjithashtu,

nuk është organizuar asnjë **site- visit**, që do t'u mundësonte operatorëve ekonomik verifikimin real në terren të vëllimit dhe kompleksitetit të punimeve.

Nëse Autoriteti Kontraktues thekson se rrënimet do të kryhen sipas kërkesave të Komunës, atëherë lind pyetja logjike dhe juridike: si është përcaktuar paraprakisht sasia e saktë prej **1,500 m³** dhe mbi çfarë baze teknike është përllogaritur kjo sasi? Pa projekte, pa lokacione dhe pa elaborime konkrete teknike, operatorët ekonomikë nuk kanë mundësi të bëjnë kalkulim real të kostos, të rrezikut financiar, të angazhimit të makinerisë dhe të fuqisë punëtore. Një situatë e tillë krijon pasiguri juridike dhe ekonomike dhe ndikon drejtpërdrejt në formimin e çmimit të ofertës."

Me datën **20.02.2026**, AK – Komuna e Pejës ka theksuar se kërkesa për rishqyrtim aprovohet pjesërisht si e bazuar dhe se ndryshohet **Aneksi 1**, gjë që vërtetohet edhe me **Formularin B54**, të datës **04.03.2026**

Mbi të gjitha, pas aprovimit, vetë AK – Komuna e Pejës, në vendimin për rishqyrtim, ka theksuar se, (citim): bazuar në analizat statistikore gjatësinë e rrjetit ekzistues të kanaleve të hapura; Evidencat e ndërhyrjeve të realizuara gjatë viteve paraprake; Nevojën periodike për largimin e sedimentit për sigurimin e funksionalitetit hidraulik. Mesatarja vjetore e pastrimit është projektuar për dy vite kontraktuale.. Gjithashtu, lidhur me lokacionet, sipas pikës 5 të vendimit, është theksuar se ndërhyrjet realizohen sipas nevojave reale dhe vendimeve administrative për shpronësim, prandaj lokacionet nuk mund të jenë të përcaktuara plotësisht paraprakisht, por bazohen në vendimet që lëshohen gjatë periudhës kontraktore.

Andaj, ne si GOE, duke u bazuar në këto vendime dhe ndryshime të bëra nga vetë Autoriteti Kontraktues, kemi konstatuar dhe vlerësuar se sasi të e parapara janë rreth **1,500 m³** në vit. Për më tepër, vetë AK, në përfundim të vendimit, ka theksuar se operatorët ekonomik kanë informacione të mjaftueshme për përgatitjen e ofertave të tyre. Duke u mbështetur në këto të dhëna zyrtare, ne kemi ofertuar çmimin prej **1.50 €/m³**

- **Përshkrimi i metodës së pastrimit**

Ne si GOE kemi planifikuar metoden e thjeshtë të pastrimit me largimi Eskavator-Kamion, sipas paramasës së dosjes, ashtu siq janë specifikuar në pozicione

- **Lloji makinerisë dhe numri i kamionëve**

Në ofertën tonë kemi paraqitur eskavatorët dhe pajisjet e tjera përcjellëse që nevojiten për realizimin e këtij projekti që do të ekzekutohet sipas paramasës së DT-së dhe për këtë i keni dëshmit e paisjeve edhe në dosje që rezulton se nga dëshmit e ofruara ne jemi të gatshëm të ekzekutojm kontratën pa asnjë dilem të vetme dhe në kohën optimale të kërkuar nga AK për shërbimin sipas kontratës.

Të njëjtat dëshmi i kemi dorëzuar edhe në ofertën tonë, duke i specifikuar më saktë në listën e pajisjeve. Gjithashtu, kemi paraqitur edhe kontratën e qirasë së makinerive me disa OE të tjerë siq janë në ofertën tone e dorëzuar në platformen e-prokurimi.

- **Numri i puntorëve dhe produktiviteti i planifikuar**

Duke qenë se në DT janë kërkuar të angazhohen 5 punëtorë, ne si konzorcium kemi paraqitur listat e punëtorëve, si të liderit ashtu edhe të anëtarit të konzorciumit. Nga kjo pikëpamje, ose lideri ose anëtari do të angazhojë staf prej 5 punëtorëve, të cilët do të kryejnë për kryerjen e këtyre shërbimeve sipas kërkesave të AK-së.

Duke pasur parasysh se punëtorët tanë janë me kosto fikse, me paga fikse mujore, si në zbatimin e kësaj kontrate ashtu edhe të kontratave të tjera, të cilët janë të angazhuar paraprakisht, përlogaritja është si vijon:

$5 \text{ punëtorë} \times 500.00 \text{ €} = 2,500.00 \text{ €}.$

Kostoja e transporti, deponimi materialit, kostoja e deponimit, kostoja operative

Duke marrë parasysh vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim të AK-së, të datës 20.02.2026, para fazës tenderuese, ku është potencuar se lokacionet nuk mund të jenë të përcaktuara plotësisht paraprakisht, por bazohen në vendime administrative, edhe ne, duke u bazuar në këtë vendim të AK-së, nuk mund të japim një lokacion të saktë.

Megjithatë, për korrektësi, marrim si pikë reference qendrën e Pejës. Nga sheshi i qytetit deri te deponia në Sferkë distanca është rreth 40 km, apo 80 km vajtje-ardhje.

Me një shpenzim për kamion prej rreth 20 litra $\times 1.25 \text{ €}$, sipas çmimit të derivateve në muajin mars 2026, rezultojnë 25 € për një ngarkesë prej 20–22 m³ në kamion.

Një kamion, mesatarisht, arrin të realizojë 15 transportime, respektivisht 330 m³, me një shpenzim total prej rreth 230 €.

Kapaciteti i kamionëve sipas DT-së është kërkuar të jetë vetëm 1 kamion. Ne kemi ofruar disa kamionë, mirëpo sipas kërkesës së AK-së, gjatë intervenimit do të angazhohet vetëm një kamion. Kostoja mesatare për kilometër është rreth 0.25–0.30 €.

Kostoja e ngarkimit dhe shkarkimit

Për ngarkimin, sipas Dosjes së Tenderit është kërkuar 1 eskavator me goma, ndërsa shpenzimet për 1 orë janë rreth:

$20 \text{ litra} \times 1.25 \text{ €} = 25 \text{ €}.$

Me 4 orë efektive pune, rezultojnë 100 €, të cilat ndahen për 330m³ në ditë, duke rezultuar në rreth 0.30 €/m³.

Nuk ka kosto për deponimin e materialit, pasi i njëjti, pas rrënimit, ngarkohet drejtpërdrejt në kamion dhe dërgohet në deponi

Përqindja e fitimit

Përqindja e fitimit është 10%, pasi nga ky projekt, përveç fitimit, pretendojmë të punojmë edhe për imazh të kompanisë, dhe të kemi kontrata me Komunën e Pejës dhe të fitojmë referenca që do të na ndihmojnë në projektet e tjera.

Çdo dokument

Nga të gjitha pikat e lartcekura kemi konstatuar dhe bashkëngjitur dokumentet përkatëse,

të cilat janë të nevojshme dhe të dedikuara për këtë projekt që gjinden në ofertën tonë të dorëzuar në platformën e-prokurimi.

POZICIONI 3:

- **Analiza e detajuar e çmimit për 1 m³**

Ne si GOE, duke u bazuar në **Aneksin 1** të Dosjes së Tenderit dhe në paramasën/ofertën, ku është kërkuar që çmimi të ofertohej për m³, më saktësisht për **pozicionin 3**, ku kërkohet sasia prej **2,000 m³** deklaron qartë sasinë dhe vëllimin, kemi ofertuar çmimin prej **1.70 €/m³**, të analizuar në mënyrë të detajuar sipas kërkesave të AK-së në Dosjen e Tenderit dhe në paramasë.

Mbi të gjitha, në kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga ne si GOE, konkretisht anëtar i konzorciumit **CONEX**, të datës **03.03.2026**, para hapjes së ofertave, është potencuar se:

"Në procedurën aktuale, Autoriteti Kontraktues ka paraparë sasi prej **2,000 m³** për periudhë 24-mujore. Megjithatë, në Dosjen e Tenderit nuk janë dhënë lokacionet konkrete të objekteve për rrënim, nuk është bashkëngjitur asnjë projekt apo elaborat teknik për të vërtetuar sasinë, nuk janë paraqitur paramasa të detajuara sipas objekteve individuale dhe nuk është dhënë asnjë arsytim mbi metodologjinë e kalkulimit të kësaj sasive. Gjithashtu, nuk është organizuar asnjë **site- visit**, që do t'u mundësonte operatorëve ekonomik verifikimin real në terren të vëllimit dhe kompleksitetit të punimeve.

Nëse Autoriteti Kontraktues thekson se rrënimet do të kryhen sipas kërkesave të Komunës, atëherë lind pyetja logjike dhe juridike: si është përcaktuar paraprakisht sasia e saktë prej **2,000 m³** dhe mbi çfarë baze teknike është përlogaritur kjo sasi? Pa projekte, pa lokacione dhe pa elaborime konkrete teknike, operatorët ekonomikë nuk kanë mundësi të bëjnë kalkulim real të kostos, të rrezikut financiar, të angazhimit të makinerisë dhe të fuqisë punëtore. Një situatë e tillë krijon pasiguri juridike dhe ekonomike dhe ndikon drejtpërdrejt në formimin e çmimit të ofertës."

Me datën **20.02.2026**, AK – Komuna e Pejës ka theksuar se kërkesa për rishqyrtim aprovetohet pjesërisht si e bazuar dhe se ndryshohet **Aneksi 1**, gjë që vërtetohet edhe me **Formularin B54**, të datës **04.03.2026**

Mbi të gjitha, pas aprovimit, vetë AK – Komuna e Pejës, në vendimin për rishqyrtim, ka theksuar se, (citim): bazuar në analizat statistikore gjatësinë e rrjetit ekzistues të kanaleve të hapura; Evidencat e ndërhyrjeve të realizuara gjatë viteve paraprake; Nevojën periodike për largimin e sedimentit për sigurimin e funksionalitetit hidraulik. Mesatarja vjetore e pastrimit është projektuar për dy vite kontraktuale.. Gjithashtu, lidhur me lokacionet, sipas pikës 5 të vendimit, është theksuar se ndërhyrjet realizohen sipas nevojave reale dhe vendimeve administrative për shpronësim, prandaj lokacionet nuk mund të jenë të përcaktuara plotësisht paraprakisht, por bazohen në vendimet që lëshohen gjatë periudhës

kontraktore.

Andaj, ne si GOE, duke u bazuar në këto vendime dhe ndryshime të bëra nga vetë Autoriteti Kontraktues, kemi konstatuar dhe vlerësuar se sasi të e parapara janë rreth **2,000 m³** në vit. Për më tepër, vetë AK, në përfundim të vendimit, ka theksuar se operatorët ekonomik kanë informacione të mjaftueshme për përgatitjen e ofertave të tyre. Duke u mbështetur në këto të dhëna zyrtare, ne kemi ofertuar çmimin prej **1.70 €/m³**

- **Përshkrimi e grumbullimit të mbeturinave**

Ne si GOE kemi planifikuar metodën e thjeshtë të pastrimit me ngarkim-largimi Eskavator-Kamion, sipas paramasës së dosjes, ashtu siq janë specifikuar në pozicione

- **Lloji makinerisë dhe numri i kamionëve**

Në ofertën tonë kemi paraqitur eskavatorët dhe pajisjet e tjera përcjellëse që nevojiten për realizimin e këtij projekti që do të ekzekutohet sipas paramasës së DT-së dhe për këtë i keni dëshmit e paisjeve edhe në dosje që rezulton se nga dëshmit e ofruara ne jemi të gatshëm të ekzekutojm kontratën pa asnjë dilem të vetme dhe në kohën optimale të kërkuar nga AK për shërbimin sipas kontratës.

Të njëjtat dëshmi i kemi dorëzuar edhe në ofertën tonë, duke i specifikuar më saktë në listën e pajisjeve. Gjithashtu, kemi paraqitur edhe kontratën e qirasë së makinerive me disa OE të tjerë siq janë në ofertën tone e dorëzuar në platformën e-prokurimi.

- **Numri i puntorëve dhe produktiviteti i planifikuar**

Duke qenë se në DT janë kërkuar të angazhohen 5 punëtorë, ne si konzorcium kemi paraqitur listat e punëtorëve, si të liderit ashtu edhe të anëtarit të konzorciumit. Nga kjo pikëpamje, ose lideri ose anëtari do të angazhojë staf prej 5 punëtorëve, të cilët do të kyçen për kryerjen e këtyre shërbimeve sipas kërkesave të AK-së.

Duke pasur parasysh se punëtorët tanë janë me kosto fikse, me paga fikse mujore, si në zbatimin e kësaj kontrate ashtu edhe të kontratave të tjera, të cilët janë të angazhuar paraprakisht, përllogaritja është si vijon:

$$5 \text{ punëtorë} \times 500.00 \text{ €} = 2,500.00 \text{ €}.$$

Kostoja e transporti, deponimi materialit, kostoja e deponimit, kostoja operative

Duke marrë parasysh vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim të AK-së, të datës **20.02.2026**, para fazës tenderuese, ku është potencuar se lokacionet nuk mund të jenë të përcaktuara plotësisht paraprakisht, por bazohen në vendime administrative, edhe ne, duke u bazuar në këtë vendim të AK-së, nuk mund të japim një lokacion të saktë.

Megjithatë, për korrektësi, marrim si pikë reference qendrën e Pejës. Nga sheshi i qytetit deri te deponia në Sferkë distanca është rreth **40 km**, apo **80 km** vajtje-ardhje.

Me një shpenzim për kamion prej rreth **20 litra × 1.25 €**, sipas çmimit të derivateve në muajin mars 2026, rezultojnë **25 €** për një ngarkesë prej **20–22 m³** në kamion.

Një kamion, mesatarisht, arrin të realizojë **15 transportime**, respektivisht **330 m³**, me një

shpenzim total prej rreth **230 €**.

Kapaciteti i kamionëve sipas DT-së është kërkuar të jetë vetëm **1 kamion**. Ne kemi ofruar disa kamionë, mirëpo sipas kërkesës së AK-së, gjatë intervenimit do të angazhohet vetëm një kamion. Kostoja mesatare për kilometër është rreth **0.25–0.30 €**.

Kostoja e ngarkimit dhe shkarkimit

Për ngarkimin, sipas Dosjes së Tenderit është kërkuar **1 eskavator me goma**, ndërsa shpenzimet për **1 orë** janë rreth:

20 litra × 1.25 € = 25 €.

Me **4 orë efektive pune**, rezultojnë **100 €**, të cilat ndahen për **330m³** në ditë, duke rezultuar në rreth **0.30 €/m³**.

Nuk ka kosto për deponimin e materialit, pasi i njëjti, pas rrënimit, ngarkohet drejtpërdrejt në kamion dhe dërgohet në deponi

Përqindja e fitimit

Përqindja e fitimit është **10%**, pasi nga ky projekt, përveç fitimit, pretendojmë të punojmë edhe për imazh të kompanisë, dhe të kemi kontrata me Komunën e Pejës dhe të fitojmë referenca që do të na ndihmojnë në projektet e tjera.

Çdo dokument

Nga të gjitha pikat e lartcekura kemi konstatuar dhe bashkëngjitur dokumentet përkatëse, të cilat janë të nevojshme dhe të dedikuara për këtë projekt që gjinden në ofertën tonë të dorëzuar në platformën e-prokurimi

Përfundim:

Për të tre pozicionet kërkohet gjithashtu:

Analiza financiare e ofertës në tërësi. –(Kemi sqaruar të gjitha pozicionet veq e veq konform neni 61 të LPP-së dhe neni 41 i RrPP-së)

Struktura e kostos sipas secilit pozicion. –(Kemi sqaruar të gjitha pozicionet veq e veq konform neni 61 të LPP-së dhe neni 41 i RrPP-së)

Shpjegimi i faktorëve ekonomikë ose teknikë që kanë mundësuar ofertimin me këto çmime. –(Kemi sqaruar të gjitha pozicionet veq e veq konform neni 61 të LPP-së dhe neni 41 i RrPP-së)

Dëshmi për posedimin ose sigurimin e kapaciteteve teknike. –(Kemi sqaruar të gjitha pozicionet veq e veq konform neni 61 të LPP-së dhe neni 41 i RrPP-së)

Dëshmi për burimet njerëzore të planifikuara. –(Kemi sqaruar të gjitha pozicionet veq e veq konform neni 61 të LPP-së dhe neni 41 i RrPP-së)

Çmimet ose ofertat nga furnitorët, nëse janë përdorur për përlogaritjen e kostove. (Kryesisht kemi paisjet tona dhe se nuk kemi qenë të detyruar të pranojm oferta nga të tjerët

Çdo dokument tjetër që dëshmon se kontrata mund të realizohet plotësisht sipas Specifikimeve Teknike, Paramasës dhe Kushteve të Kontratës pa cenuar cilësinë e punimeve.(Sqarimi tona si GOE kemi dhënë në këtë shkresë dhe i qendrojm mbrapa me përkushtim ekzekutimit të kontratës ashtu siq e kemi sqaruar edhe më lartë duke u bazuar në paramasën e dosjes së tenderit, specifikimit teknik dhe kushteve kontratës)

Për cdo sqarim shtese AK-mund të kërkoj përsëri info shtese

GOE:DARDANIAA SH.P.K & CONEX L.L.C



Bazuar në Vendimin e Autoritetit Kontraktues (AK) pas rivlerësimit, rezulton se është shpallur një Operator Ekonomik (OE) i suksesshëm, një OE i pasuksesshëm, ndërsa ne si GOE jemi eliminuar nga procedura. Ndërkohë, të gjithë operatorët e tjerë ekonomik nuk e kanë vazhduar validitetin e ofertës dhe sigurimin e ofertës.

Arsyetimi për eliminimin tonë nuk qëndron në asnjë aspekt, pasi oferta jonë nuk është me çmim jo-normalisht të ulët. Kjo dëshmohet edhe sipas formulës së përcaktuar në **Udhëzuesin Nr. 002/2024 për Plotësim-Ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik**, konkretisht në **nenin 11 dhe nenin 61 të LPP-së**, i cili rregullon mënyrën e përcaktimit të ofertave me çmim jo-normalisht të ulët.

Albani AA LLC – 75,250.00 € (OE i rekomanduar për kontratë)

GOE Dardania SH.P.K. & Conex L.L.C. – 58,850.00 € (oferta jonë)

Horn & Co Kosova SH.P.K. – 84,450.00 €

Totali i ofertave: 218,550.00 €

Mesatarja e ofertave:

218,550.00 € ÷ 3 = 72,850.00 €

Pragu prej 30%:

$72,850.00 \text{ €} \div 1.30 = 56,038.46 \text{ €}$

Prandaj, vetëm ofertat që janë nën vlerën **56,038.46 €** konsiderohen oferta me çmim jo-normalisht të ulët, ndërsa oferta jonë prej **58,850.00 €** është mbi këtë prag dhe, rrjedhimisht, nuk mund të konsiderohet ofertë me çmim jo-normalisht të ulët.

Nga kjo rezulton qartë se Autoriteti Kontraktues, në mënyrë tendencioze, na ka eliminuar duke mos e zbatuar kriterin ligjor për përcaktimin e ofertës me çmim jo-normalisht të ulët.

Për më tepër, jemi eliminuar padrejtësisht, ndonëse oferta jonë është **16,400.00 €** më e lirë se oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë. Me këtë veprim, AK nuk ka respektuar parimet e ekonomicitetit dhe efikasitetit në shpenzimin e mjeteve publike, të përcaktuara në nenet 1 dhe 6 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Po ashtu, AK nuk i ka marrë fare parasysh sqarimet tona të dorëzuara më **06.07.2026**, të cilat janë përgatitur dhe elaboruar në mënyrë të detajuar për secilin pozicion, në përputhje me nenin 61 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Neni 61 i LPP-së përcakton se gjatë vlerësimit nëse një tender është apo duket të jetë me çmim jo-normalisht të ulët, autoriteti kontraktues duhet të marrë parasysh shpjegimet e tenderuesit lidhur me:

- ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve ose të metodave të ndërtimit;
- zgjidhjet teknike të ofruara;
- kushtet veçanërisht të favorshme që operatori ekonomik ka në dispozicion për furnizimin e produkteve, ofrimin e shërbimeve ose realizimin e punëve; dhe
- origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve ose punëve të propozuara.

Ne, si GOE, kemi dhënë sqarime të plota dhe të argumentuara në përputhje me nenin 61 të LPP-së. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk i ka marrë ato fare në konsideratë, gjë që dëshmon se qëllimi i tij nuk ka qenë vlerësimi objektiv i ofertës sonë, por eliminimi ynë nga procedura dhe shpërblimi i një operatori tjetër ekonomik.

Gjithashtu, vlen të theksohet se nga AK-Komuna Pejë na është dërguar kërkesa për sqarime me datë **03.07.2026**, në orën **14:30**, ndërsa afati për përgjigje e ka caktuar AK në këtë sqarim se është caktuar deri më **06.07.2026**. Kjo do të thotë se kërkesa është dërguar të premten, pak para përfundimit të orarit zyrtar të punës, ndërsa përgjigjja është kërkuar për të hënë. Duke pasur parasysh se administrata publike punon nga e hëna deri të premten, nga ora 08:00 deri në 16:00, dhe nuk punon të shtunën dhe të dielën, afati i dhënë ka qenë jashtëzakonisht i shkurtër dhe jo i arsyeshëm. Kjo lë të kuptohet se veprimet e AK-së kanë qenë tendencioze ndaj ofertës sonë.

Megjithatë, pavarësisht afatit shumë të shkurtër dhe kërkesave të detajuara, ne i kemi përgatitur dhe dorëzuar të gjitha sqarimet brenda afatit të kërkuar.

Edhe herën e parë, Autoriteti Kontraktues na eliminoi padrejtësisht.

Ne si GOE duke e parë padrejtësinë e AK-së ndaj nesh, jemi detyruar ti kërkojmë të drejtat tona ligjore, që i paraqitëm ankesës në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), i cili organ e aprovoi ankesën tonë si të bazuar dhe e ktheu lëndën në rivlerësim.

Megjithatë, pas rivlerësimit, menduam se AK do ta respekton Vendimin e OSHP-se **nr.2026-0320 të datës 24.06.2026**, por AK përsëri na eliminoi padrejtësisht me vendimin e rivlerësimit të ofertave të datës **14.07.2026**.

Ky vendim është marrë tetë (8) ditë pas dorëzimit të sqarimeve tona të datës **06.07.2026**, pa u mbështetur në ndonjë dispozitë ligjore konkrete, por vetëm në supozime dhe vlerësime tendencioze.

Nëse ne si GOE, nuk do t'u qëndronim pas çmimeve të ofruara në ofertën tonë, ne si GOE jemi të gatshëm sipas kriterëve të dosja që do ta paraqesim sigurimin e ekzekutimit në vlerë prej **10%** të kontratës, i cili kërkohet si në Njoftimin për Kontratë ashtu edhe në Dosjen e Tenderit dhe mbetet i vlefshëm për 30 ditë pas përfundimit të kontratës.

Në letrën tonë të sqarimeve kemi elaboruar në mënyrë të detajuar secilin pozicion, duke paraqitur makineritë, numrin e punëtorëve dhe mënyrën e realizimit të punimeve. Ne i kemi qëndruar dhe vazhdojmë t'u qëndrojmë çmimeve të ofruara deri në përfundimin e kontratës.

Po ashtu, vlen të theksohet se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nga Komuna Pejë, OE **Albani AA LLC**, i cili ka ekzekutuar edhe kontratën paraprake me titull të njejtë të rrënimeve me nr. të prokurimit **635-25-3777-2-2-1**, në pozicionin **nr. 2** ka ofertuar çmimin **2.00 €**, ndërsa në këtë procedurë ka ofertuar çmimin **2.50 €**.

Prandaj, **shtrohet pyetja:** si ka qenë e mundur që i njëjti operator ta realizojë kontratën me çmimin **2.00 €**, ndërsa tani pretendohet se çmimi prej **2.50 €** nuk është i realizueshëm, kur dihet se nga viti 2025 e deri më sot nuk ka pasur ndryshime të konsiderueshme të çmimeve që do ta arsyetonin një pretendim të tillë?

Kjo dëshmon se arsyetimi i Autoritetit Kontraktues është tendencioz dhe jo i mbështetur në fakte objektive.

Poashtu edhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Pejës, së bashku me Komisionin e Vlerësimit, nuk i ka zbatuar kriteret e përcaktuara si te Njoftimi për Kontratë dhe Dosja e Tenderit, sepse ky komision së bashku me ZPP nuk e kanë zbatuar nenin 59 të LPP-së, por ka marrë një vendim të pabazuar në ligj dhe në faktet e paraqitura.

Prandaj lirisht themi se AK-Komuna Pejë, nuk i ka shqyrtuar pretendimet ankimore sipas nenit 108A të LPP-se, duke mos i marr parasysh pretendimet tona dhe duke na eliminuar pa u bazuar në fakte dhe prova, ku ne asnjë pike nuk qëndron arsyetimi i AK-së dhe kjo e dëshmon se AK pa asnjë bazë na eliminon duke u bazuar në nenin 61 të LPP-së, por në fakt e bën shkeljen e nenit 61 të LPP-së, poashtu edhe nenit 11 të Udhëzuesit të Prokurimit Publik, duke mos e marr fare parasysh formulën për çmime jo normalisht të ulëta që e kemi elaboruar në brendi të kësaj

ankese, andaj këto arsyetime të eliminimit tonë janë të paqëndrueshme dhe të pabazuar në prova dhe fakte konkrete, por me qëllim të vetëm eliminimit tonë dhe favorizimit të OE-së tyre preferuar ashtu siç ka vepruar dy herë radhazi me vendimet paraprake.

Prandaj, të gjitha pretendimet dhe arsyetime tona të elaboruara në këtë ankesë e dëshmojnë se eliminimi jonë si GOE është i pabazuar në prova dhe fakte, por shihet se është eliminim tendencioz ndaj neve si ofertues.

Poashtu, në vazhdim do ti paraqesim pretendimet tona edhe për OE e rekomanduar që është i papërgjegjshëm e që AK e ka rekomanduar për kontratë.

Pretendimet ankimore lidhur me OE e rekomanduar që dëshmohet se është OE i papërgjegjshëm sipas kriterëve të DT-së.

Gjatë qasjes që kemi pasur për OE e rekomanduar të lista e kontratave të kriteret e dosjes të kapaciteti teknik dhe/ose profesional, të kriteri shumë qartë kërkohet:

Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për punë ndërtimore në vlerë totale prej 120,000.00 Euro gjatë 3 (tri) viteve të fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Në rast të grupit të operatorëve ekonomikë, udhëheqësi duhet të ketë realizuar së paku 60% të vlerës së kërkuar gjatë 3 (tri) viteve të fundit.

-Elaborim i kriterit: OE duhet ta përmbush kriterin e kërkuar për listën e kontratave së paku 120,000 Euro, kurse në rast konzorciumi lideri duhet ti plotëson 60%. Nga kriteri i kërkuar në DT nga vet Autoriteti Kontraktues, konkretisht ZPP nuk e ka respektuar kriteri i kërkuar për shkak se:

-Në listën e OE së rekomanduar ka të prezantuar vetëm **dy projekte**, ku për të dy projektet OE i rekomanduar **ALBANI AA, është anëtar i konzorciumit e jo lider**, atëherë AK për ta respektuar kriterin e vet të dosjes ka qenë dasht të verifikoj përmes qarkullimit bankar dhe marrëveshjes së konzorciumit për ato dy projekte. Prandaj, shtrohet pyetja se si e ka vërtetuar AK se OE i rekomanduar OE ALBANI e përmbush kriterin e kërkuar 120,000 Euro, pasi që bashkë me liderin e kanë përmbush, kurse në dy kontratat OE ALBANI AA është anëtar i grupit e jo Lider, andaj po të deshifrohet shihet se nuk e përmbush as 48,000 Euro, e lëre 120,000 € ashtu siç e kërkon kriteri i DT-së dhe NJK-së.

Andaj në rast se kishte qenë marrëveshja e konzorciumit që Lideri 60 % e anëtari 40%, atëherë e kalkulojmë:

$120,000 \times 60\% \text{ lideri} = 72,000 \text{ €} - \text{Lideri (LURN SHPK), kurse}$

$120,000 \times 40\% = 48\,000 \text{ Euro} - \text{anetari i grupit ALBANI AA}$

Atëherë si mund të jetë i përgjegjshëm një OE në rast se nuk e përmbush kriterin e kërkuar të referencave sipas kriterit të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë ashtu siç e përcakton edhe neni 69 i LPP-së.

Prandaj, nga ky kalkulim dëshmohet se OE i rekomanduar është i papërgjegjshëm, ashtu siç e definojnë edhe neni 59.4 i LPP-së.

-Poashtu OE i rekomanduar nuk e plotëson kriterin e kërkuar Kapacitetin teknik dhe/ose profesional – Listen e mjeteve, pajisjeve, që do ta elaborojmë më poshtë:

Kriteri i kërkuar i DT-së dhe NJK-së:

Kërkes 3	Lista e mjeteve te punës.	1.Kamion minimum 10m3	minimum-1copë
	2.Eskavator me goma minimum 1copë	3.Kamionet minimum 1copë	
	4.Kompresor minimum 2copë	5. Hilt minimum 2copë	

Dëshmia 3. Lista e pajisjeve – mjeteve të punës që OE duhet ti ketë të vetat apo të kontraktuara (apo me qira ne emere te keti projekti per kozgjatjen e kontrates), të dëshmohen me kopje të librezave, deklaratë doganore. (me dud doganor) Të dëshmohet se pajisjet mtorike janë të regjistruara dhe kanë sigurim valid- Kopja e librezave të paisjeve. O.E të cilet nuk i kan paisjet e regjistruara eliminohen nga ky A.Ptë eliminohet.

Te bashkangjitur gjeni listen e pajisjeve:

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “CONEX L.L.C.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rrënimi i objekteve të shpronësuar nga Komuna e Pejës” me numër të prokurimit: “635-26-580-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

ALBANI AA.LLC					
LISTA E MAKINERISE				2026	
Nr	Lloji	Viti	Pesha	Fat+Dud.doganor	Pronsia
1	Libher A904 C	2006	20.000 kg	Fat+Dud.doganor	ALBANI AA LLC
2	Actros 3246	2010	13860 kg	03-507-JJ	ALBANI AA LLC
3	Actros 3244	2009	16860 kg	03-506-JF	ALBANI AA LLC
4	Ww-Transporter	1997	1660 kg	03-721-FH	Qera
5	Komatsu+gekiq	2002	23500 kg	Dud doganor	Qera
6	Kompresor	2005	950kg	Fat+Dud.doganor	ALBANI AA LLC
6	Kompresor	1979	1005 kg	Dud doganor	Qera
7	Gekiq bageri hidraulik	2023	400kg	Fatur;202300488	ALBANI AA LLC

ALBANI AA LLC




Te pajisja **Kompresor minimum 2 copë**, gjatë qasjes qe kemi pasur kemi vërejtur se nuk i ka dëshmuar DUD-in siç kërkohet në kriterin e dosjes, por ka dorëzuar një foto dhe një dokument të kompresorit që nuk dëshmohet se është as DUD as faturë pasi që është e padukshme dhe e palexueshme, andaj si ka mund komisioni i vlerësimit dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit ta verifikoj këtë dokument?

Te bashkangjitur gjeni provën nga Platforma e-prokurim per dokumentin e dorëzuar nga OE i rekomanduar (ALBANI AA):



PROVË: Dokument-i i kompresorit i pa lexueshëm:

Bazuar në dokumentin e bashkangjitur si ka mund ta verifikon komisioni i vlerësimit dhe zyrtari Përgjegjës i Prokurimit se bëhet fjalë për kompresorin,



Nga ky dokument nuk mund të deshifrohet asgjë, andaj si ka mund ta verteton se bëhet fjalë për kompresor dhe si e ka konstatuar se është në rregull kompresori sipas kriterit të dosjes.

-Poashtu për pajisjet e kërkuara: Hilt dy (2) copë, nuk e ka bashkangjitur asnjë as në listen e pajisjeve dhe as nuk ka bashkangjitur ndonjë marrëveshje për Hilt-a, andaj si ka mundur komisioni i vlerësimit dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit ta tejkaloj këtë kriter ku e pa e disponuar fare në dosje e shpallë të përgjegjshëm OE. ALBANI AA. Gje që konsiderohet i papërgjegjshëm sipas LPP-së.

Andaj kjo e dëshmon se OE i rekomanduar as listën e pajisjeve nuk e plotëson ashtu siç kërkohet në kriterin e DT-së dhe NJK-së, andaj si ka mund të jetë i përgjegjshëm kur neni 59.4 i LPP-së e sqaron qartë se një OE mund të jetë i përgjegjshëm nëse i plotën të gjitha kriteret e kërkuara të njoftimit për kontratë dhe të dosjes së tenderit. Prandaj OE i rekomanduar nuk është i përgjegjshëm sipas nenit 59.4 të LPP-së, andaj duhet të eliminohet e jo të rekomandohet për kontratë.

Me këto veprime Zyrtari përgjegjës i Prokurimit ka bërë shkeljen e nenit 24 të LPP-së dhe duhet ti revokohet licenca e prokurimit sipas paragrafit 8 të nenit 25 të LPP-së, pasi që e rekomandon për kontratë një OE të papërgjegjshëm duke mos i plotësuar shumë kritere të dosjes dhe njoftimit për kontratë dhe duke e dëmtuar buxhetin publik në vlerë prej 16,400.00 €. Andaj kërkoj nga ju si OSHP që të merrni vendim për revokim të Licencës për Zyrtarin Përgjegjës të Prokurimit të Komunës së Pejës.

-Poashtu gjatë qasjes që kemi pasur kemi vërejtur se te lista e kërkuar konkretisht te staffi teknik janë kërkuar 5 punëtorë sipas profileve, kurse OE i rekomanduar e ka dorëzuar një Listë të ATK-së të datës 09.03.2026 me 5 emra e që deklarimi për ata punëtorë nuk dihet fare, pasi që nuk kanë as kontrata të punës për ti evidentuar profesionet e tyre. Madje madje nga lista shihet se kontributet e punëtorëve janë të muajit janar, që dëshmohej se nuk kanë të paguar kontribute as për muajin shkurt as për mars etj.

- Prandaj, nga kjo shihet se AK nuk e ka respektuar kriterin e dosjes së tenderit dhe mos dorëzimi i kontratave dhe profileve të punëtorëve e bën të papërgjegjshme ofertën e tij, andaj edhe me këtë AK konkretisht ZPP ka bërë shkeljen e nenit 59.4 të LPP-së.

-Poashtu në dosje e OE së rekomanduar shihet se OE i rekomanduar nuk e ka nënshkruar dhe as vulosur specifikimin teknik të detyrueshëm që është obligim për çdo ofertues që ti qëndroj mbrapa atij specifikimi për kryerjen e punëve sipas asaj që kërkohet, andaj kjo e dëshmon se OE e qet në lajthitje AK-në apo dyshojmë se AK dhe komisioni i vlerësimit me dashje kanë vepruar në këtë mënyrë, duke mos e marr fare parasysh specifikimin teknik që duhet të jete i nënshkruar dhe vulosur nga OE ofertues..

-Gjatë qasjes kemi vërejtur edhe Certifikata e biznesit nuk i ka të bashkangjitura informatat shtesë, gjë që AK ka mund ti kërkoj sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-se gjë që nuk e ka kërkuar, andaj edhe kjo e dëshmon se AK, konkretisht ZPP haptazi e ka favorizuar duke na diskriminuar neve si OE dhe duke bërë shkeljen e nenit 7 të LPP-së.

Pra, siç e sqaruam më lartë se AK ka rekomanduar për kontratë nje OE të papërgjegjshem dhe duke na eliminuar neve si OE të pergjegjshem me çmim më të lirë dhe duke e dëmtuar buxhetit publik sipas nenit 1 dhe 6 te LPP-se, poashtu duke na diskriminuar neve si GOE sipas nenit 7 te LPP-së dhe duke e bërë shkeljen e nenit 59 të LPP-së për mos vlerësim sipas kriterve të dosjes.

Përmes kësaj ankese, kërkojmë që të merren në konsideratë të gjitha faktet, provat dhe baza ligjore, si dhe të rekomandohemi për dhënien e kontratës, pasi jemi Grup i Operatorëve Ekonomik i përgjegjshëm dhe kemi paraqitur ofertën e përgjegjshme me çmim më të lirë.

Për shkak të padrejtësive që po na bëhen neve si GOE, do t'i shfrytëzojmë të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, lidhur me procedurat pranë organeve kompetente, me qëllim që të zbardhet e vërteta dhe të mos diskriminohemi padrejtësisht, siç ka ndodhur gjatë kësaj procedure të prokurimit.

Bazuar ne pretendimet e paraqitura ne këtë ankese kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, që te merr:

VENDIM

APROVOHET e bazuar *Ankesa e datës 30.07.2026* e parashtruar nga **GOE. DARDANIA; CONEX**

ANULOHET vendimi i Autoritetit Kontraktues të datës **15.07.2026**

RIVLERËSIM i aktivitetit për shkak se oferta jonë është e përgjegjshme sipas kritereve të Dosjes dhe njoftimit për kontratë, dhe të

SHPERBLEHEMI me kontrate ne si GOE pasi që kemi çmimin më të lirë me dokumentacion të përgjegjshëm sipas ofertës së dorëzuar në platformën elektronike.

KRITERET PËR VLERËSIM

--

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

--



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



ZYRA E PROKURIMIT
KOMUNA E PEJËS

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: : Rrënimi i objekteve të shpronësuara nga Komuna e Pejës

Nr. i prokurimit ¹	635-26-580-2-2-1
Nr i brendshëm	635-26-004-221

Radhë	Lënda / grupi: Rrënimi i objekteve të shpronësuara nga Komuna e Pejës	Çmimi i Përgjithshëm (me TVSH)	Koment
1.	Albani AA L.L.C.	75.250.00 €	I përgjegjeshëm
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik DARDANIAA SH.P.K.; CONEX L.L.C.	58.850.00 €	I pa përgjegjeshëm
3.	BK - CONSTRUCTION SH.P.K.	74.075.00 €	Nuk ka vazhdu Validitetin dhe Sigurimi
4.	ARMIRING SH.P.K.	77.000.00 €	Nuk ka vazhdu Validitetin dhe Sigurimi
5.	Grup i Operatorëve Ekonomik GJIKURIA SH.P.K.- Dega në Kosovë; Jetoni Construction SH.P.K.	80.050.00 €	Nuk ka vazhdu Validitetin dhe Sigurimi
6.	Horn & Co. Kosova SH.P.K.	84.450.00 €	I pa sukseseshëm
7.	Ermal Sylaj B.I.	95.000.00 €	Nuk ka vazhdu Validitetin dhe Sigurimi
8.	Grup i Operatorëve Ekonomik NB. PROJEKT SH.P.K.; ODA E JUNIKUT SH.P.K	107.100.00 €	Nuk ka vazhdu Validitetin dhe Sigurimi

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

KOMUNA E PEJES shpërblen me kontratë Albani AA L.L.C. në vlerë totale të ofertës: **75.250.00 €**

Data: 14.07.2026

Menaxher i Prokurimit
Milot Gashi

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2026/0320 i dt:24.06.2026

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - CONEX L.L.C.

GOE “ Dardania & Conex L.L.C” - Prishtinë, aktiviteti i prokurimit me titull:“Rrënimi i objekteve të shpronësuara nga Komuna e Pejës”, me nr. të prokurimit:635-26-580-2-2-1.

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Pejës, për këtë aktivitet të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës kontratë publike kornizë -shërbim. Vlera e parashikuar e kontratës është 120,000.00 € për 24 Muaj. Ndërsa, kriter i dhënies së kontratës është “Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët**”.

Sqarim hyrës: Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për dhënie të kontratës, konkretisht kundër eliminimit të ofertës së operatorit ekonomik ankues, ku kjo procedurë e prokurimit ka qenë objekt i shqyrtimit në OSHP, ndërsa **ekspertja shqyrtuese** ka nxjerr raport të ekspertizës me Nr.320/2026, të datës 26.05.2026. Po ashtu, Paneli Shqyrtues ka gjykuar me Vendimin PSH.nr.2026/0320, të datës 24.06.2026, duke e aprovuar si të bazuar ankesën e OE “Dardania & Conex L.L.C” - Prishtinë, kurse ka anuluar njoftimin mbi vendimin e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lëndën e ka kthyer në rivlerësim.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 24, 25, 56.3, 59, 60, 61 dhe 108/A të LPP-së, si dhe shkelje të dispozitave të Udhëzuesit të Prokurim Publik, konkretisht të nenit 11 të Udhëzuesit. Pretendimet e ngritura ankimore nga ana e operatorit ekonomik ankues janë shqyrtuar nga ekspertja duke u bazuar në

shkresat e lëndës dhe jep përgjigje si në vijim.

Pretendimi ankimor 1: OE ankues potencon se AK-Komuna e Pejës, nuk i ka marrë parasysht sqarimet e dorëzuara më datë 06.07.2026, të cilat janë ofruar në përgjigje të kërkesës së AK-së për sqarime lidhur me mënyrën e formimit të çmimeve të ofertuara për secilin pozicion të paramasës dhe parallogarisë. Tutje, OE ankues potencon se arsyeja e eliminimit nga AK është si vijon:

Njoftim për Refuzim të Ofertës –OE DARDANIAA SH.P.K.; CONEX L.L.C.

Arsyetimi për mospranimin e sqarimeve të Operatorit Ekonomik lidhur me tenderin jo normalisht të ulët Komisioni i Vlerësimit, pas shqyrtimit të përgjigjes së dorëzuar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik DARDANIAA SH.P.K.; CONEX L.L.C. në përgjigje të kërkesës së Autoritetit Kontraktues (B41 – Kërkesë për informata mbi tenderin jo-normalisht të ulët), ka konstatuar se Operatori Ekonomik ka paraqitur shpjegime lidhur me mënyrën e realizimit të punimeve dhe formimin e çmimeve të ofertuara. Megjithatë, shpjegimet e dhëna kanë mbetur në nivel deklarativ dhe nuk janë mbështetur me dokumente dhe dëshmi objektive, të cilat ishin kërkuar shprehimisht nga Autoriteti Kontraktues për të provuar realizueshmërinë ekonomike dhe teknike të ofertës. Në kërkesën B41, Autoriteti Kontraktues kishte kërkuar që për secilin pozicion të Paramasës dhe Parallogarisë të paraqiteshin analiza të detajuara të kostove dhe dokumentacion mbështetës për elementet përbërëse të çmimit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, kostot e fuqisë punëtore, makinerive dhe pajisjeve, transportit, deponimit të materialit, derivateve, mirëmbajtjes, amortizimit, shpenzimeve operative dhe fitimit, si dhe çdo dokument tjetër që do të mundësonte verifikimin objektiv të realizueshmërisë së ofertës. Nga shqyrtimi i përgjigjes së Operatorit Ekonomik është konstatuar se, ndonëse janë dhënë shpjegime për mënyrën e organizimit të punimeve dhe janë përmendur burimet njerëzore dhe pajisjet në dispozicion, nuk janë dorëzuar dokumente dhe prova objektive që mbështesin këto pretendime dhe që dëshmojnë se çmimet e ofertuara mbulojnë të gjitha kostot e nevojshme për realizimin e kontratës. Komisioni vëren se dokumentet e dorëzuara në fazën e ofertimit lidhur me personelin dhe pajisjet shërbejnë për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve të kualifikimit dhe kapacitetin teknik të Operatorit Ekonomik, por ato nuk përbëjnë prova për realizueshmërinë ekonomike të çmimeve të ofertuara dhe nuk zëvendësojnë dokumentacionin e kërkuar në procedurën e shqyrtimit të tenderit jo-normalisht të ulët. Po ashtu, Operatori

Ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion mbështetës që do të mundësonte verifikimin e analizës së kostove për çmimet e ofertuara prej 2.80 €/m³, 1.50 €/m³ dhe 1.70 €/m³, si dhe nuk ka paraqitur prova objektive që vërtetojnë se me vlerën e përgjithshme të ofertës prej 58,850.00 € mund të realizohen të gjitha obligimet kontraktuale në përputhje me Specifikimet Teknike, Paramasën, Kushtet e Kontratës dhe standardet e kërkuara të cilësisë. Autoriteti Kontraktues nuk mund ta bazojë vlerësimin e realizueshmërisë së ofertës vetëm në deklaratimet e Operatorit Ekonomik. Barra për të provuar realizueshmërinë e ofertës i takon Operatorit Ekonomik përmes paraqitjes së provave dhe dokumentacionit mbështetës të mjaftueshëm dhe të verifikueshëm. Në mungesë të këtyre provave, Autoriteti Kontraktues nuk ka qenë në gjendje të verifikojë objektivisht realizueshmërinë ekonomike dhe teknike të ofertës. Për rrjedhojë, Komisioni i Vlerësimit vlerëson se sqarimet e dorëzuara nuk përmbushin kërkesat e përcaktuara në letrën B41 dhe nuk ofrojnë bazë të mjaftueshme për të konstatuar se oferta është ekonomikisht dhe teknikisht e realizueshme. Për këtë arsye, sqarimet nuk pranohen si të mjaftueshme dhe oferta e Grupit të Operatorëve Ekonomik DARDANIAA SH.P.K.; CONEX L.L.C. refuzohet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe rregulloret përkatëse që rregullojnë trajtimin e tenderëve jo-normalisht të ulët.

Tutje OE ankues potencon se bazuar në shkresën e datës 06.07.2026 kanë dërguar përgjigje të detajuar AK-së.

Provë : Shkëputur nga platforma e-prokurimit

Dërguar nga : KOMUNA E PEJES

B41 Leter Standarde e kerkeses per informata mbi tendert jo-normalisht te ulet

B41 Leter Standarde e kerkeses per informata mbi tendert jo-normalisht te ulet CONEX..pdf

03.07.2026 13:34

Hape:

Shqip

↓?

Dërguar nga : CONEX L.L.C.

Dokumenti për dërgim te AK

Sqarimi PEJE 06.07.2026.pdf

06.07.2026 13:49

Tutje OE ankues potencon se bazuar në vendimin e AK pas rivlerësimit, rezulton se është shpallur një Operator Ekonomik (OE) i suksesshëm, një OE i pasuksesshëm, ndërsa ne si GOE

jemi eliminuar nga procedura. Ndërkohë, të gjithë operatorët e tjerë ekonomik nuk e kanë vazhduar validitetin e ofertës dhe sigurimin e ofertës. Arsyetimi për eliminimin tonë nuk qëndron në asnjë aspekt, pasi oferta jonë nuk është me çmim jo-normalisht të ulët. Kjo dëshmohet edhe sipas formulës së përcaktuar në Udhëzuesin Nr. 002/2024 për Plotësim-Ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, konkretisht në nenin 11 dhe nenin 61 të LPP-së, i cili rregullon mënyrën e përcaktimit të ofertave me çmim jo-normalisht të ulët.

Albani AA LLC – 75,250.00 € (OE i rekomanduar për kontratë)

GOE Dardania SH.P.K. & Conex L.L.C. – 58,850.00 € (oferta jonë)

Horn & Co Kosova SH.P.K. – 84,450.00 €

Totali i ofertave: 218,550.00 €

Mesatarja e ofertave: $218,550.00 \text{ €} \div 3 = 72,850.00 \text{ €}$

Pragu prej 30%: $72,850.00 \text{ €} \div 1.30 = 56,038.46 \text{ €}$

Prandaj, vetëm ofertat që janë nën vlerën 56,038.46 € konsiderohen oferta me çmim jo normalisht të ulët, ndërsa oferta jonë prej 58,850.00 € është mbi këtë prag dhe, rrjedhimisht, nuk mund të konsiderohet ofertë me çmim jo-normalisht të ulët. Nga kjo rezulton qartë se Autoriteti Kontraktues, në mënyrë tendencioze, na ka eliminuar duke mos e zbatuar kriterin ligjor për përcaktimin e ofertës me çmim jo-normalisht të ulët. Për më tepër, jemi eliminuar padrejtësisht, ndonëse oferta jonë është 16,400.00 € më e lirë se oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë. Me këtë veprim, AK nuk ka respektuar parimet e ekonomicitetit dhe efikasitetit në shpenzimin e mjeteve publike, të përcaktuara në nenet 1 dhe 6 të Ligjit për Prokurimin Publik. Po ashtu, AK nuk i ka marrë fare parasysh sqarimet tona të dorëzuara më 06.07.2026, të cilat janë përgatitur dhe elaboruar në mënyrë të detajuar për secilin pozicion, në përputhje me nenin 61 të Ligjit për Prokurimin Publik. Neni 61 i LPP-së përcakton se gjatë vlerësimit nëse një tender është apo duket të jetë me çmim jo-normalisht të ulët, autoriteti kontraktues duhet të marrë parasysh shpjegimet e tenderuesit lidhur me:

- ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve ose të metodave të ndërtimit;

- zgjidhjet teknike të ofruara;
- kushtet veçanërisht të favorshme që operatori ekonomik ka në dispozicion për furnizimin e produkteve, ofrimin e shërbimeve ose realizimin e punëve; dhe
- origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve ose punëve të propozuara.

Përgjigje në pretendimin ankimor: Ekspertja shqyrtuese bazuar në shkresat e lëndës konkretisht në Letrën standarde për tenderuesit e eliminuar të datës 14.07.2026, si dhe arsyetimin e dhënë nga AK, pretendimin ankimor të OE ankues, dhe nga analiza e ofertave dhe zbatimi i formulës së përcaktuar në nenin 11 të Udhëzuesit Nr. 002/2024 për Plotësim-Ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, sqaroj se procedurën e trajtimit të tenderëve jo normalisht të ulët i rregullon neni 41 i Rregullores dhe sqarimet shtesë me të dhëna në formë tabelore i sqaron neni 11 i Udhëzuesit Nr. 02/2024. Në nenin 41 të Rregullores jepen 3 kushte kryesore që obligon AK për të kërkuar sqarime dhe shpjegime për çmimin e ofruar, ato kushte janë:

çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;

çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;

janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Ngjashëm edhe në Udhëzuesin Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, në pikën 11 (Tenderët Jo-normalisht të ulët), shembulli 1 (tabela), jepen 3 kushte kryesore të ngjashme sikurse në nenin 41 të Rregullores, që në rastin konkret tek nr. rendor 11 i tabelës paraqitet kushti 3 “pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire”.

Për tu kthyer të çështja e pretendimit ankimor të OE ankues, **ekspertja shqyrtuese** sqaron se në bazë të nenit 41 të Rregullores është plotësuar kushti i parë (janë 3 oferta të përgjegjshme), çmimi mesatar i tre tenderëve të përgjegjshëm është përcaktuar 72,850.00 euro dhe pas llogaritjes ($72,850.00 / 1.3 = 56,038.46\text{€}$) rezulton se pragu minimal për tu konsideruar një tender jo normalisht i ulët është vlera 56,038.46 euro, kurse vlera e ofertës së OE ankues është

58,850.00 euro. Pra, në këtë rast oferta e OE ankues ka çmim më të lartë se pragu prej 56,038.46 euro, që do të thotë se AK në rastin konkret ka kërkuar sqarime apo shpjegime në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në nenin 41 të Rregullores. Andaj, meqenëse në rastin konkret ky tender nuk mund të konsiderohet me çmim jo normalisht të ulët, atëherë nuk vazhdohet me kushtin e tretë të përcaktuar në nenin 11 të Udhëzuesit. Andaj AK-ë konsideroj se nuk ka pasur bazë ligjore ta konsiderojë ofertën e OE ankues si ofertë me çmim jo-normalisht të ulët, pasi oferta e tij nuk i plotëson kushtet e nenit 11 të Udhëzuesit Nr. 002/2024 për Plotësim-Ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023, për t’u kualifikuar si e tillë. Pretendimi ankimor është i bazuar.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë është e papërgjegjshëm pasi që nuk plotëson kërkesat e DT dhe të njoftimit për kontratë, **ekspertja shqyrtuese** sqaron se OE ankues këto pretendime nuk i ka parashtruar tek kërkesa për rishqyrtim e datës 20.07.2026, andaj bazuar në nenin 64.2 të Rregullores nr. 001-2022 për Prokurim Publik në të cilën thuhet :

64.2 Ankesa do të përgatitet dhe dorëzohet tek Organi Shqyrtues i Prokurimit nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksionit të dedikuar “Ankesat”. Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues.

Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, **ekspertja shqyrtuese** i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 14.07.2026 dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “CONEX L.L.C.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rrënimi i objekteve të shpronësuar nga Komuna e Pejës” me numër të prokurimit: “635-26-580-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E PEJES**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **CONEX L.L.C.**



Majlinda Bedrolli